



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

**PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2014**

**I DETYRUAR**

**VARIANTI B**  
 Ora 10.00

E premte, 30 maj 2014

Lënda: Gjuhë shqipe dhe Letërsi

Profesionale, artistike, sportive, me kohë të shkurtuar

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **25 pyetje**: 13 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe 12 pyetje me zhvillim.

Testi është i ndarë në dy pjesë: joletrare dhe letrare.

Në të dy pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

<b>Kërkesa</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>8</b>	<b>9a</b>	<b>9b</b>	<b>9c</b>
<b>Pikët</b>											
<b>Kërkesa</b>	<b>10</b>	<b>11</b>	<b>12</b>	<b>13</b>	<b>14</b>	<b>15</b>	<b>16</b>	<b>17</b>	<b>18</b>	<b>19</b>	<b>20</b>
<b>Pikët</b>											
<b>Kërkesa</b>	<b>21</b>	<b>22</b>	<b>23a</b>	<b>23b</b>	<b>24a</b>	<b>24b</b>	<b>25a</b>	<b>25b</b>	<b>25c</b>	<b>25d</b>	
<b>Pikët</b>											

Totali i pikëve

**KOMISIONI I VLERËSIMIT**

1.....Anëtar

2.....Anëtar

## *Në studion tonë fotografike*

Mirëmëngjesi! Unë jam Eva dhe jam një fotografe profesioniste e kësaj studioje. Kam qenë fotografe profesioniste te një studio tjetër për dhjetë vjet dhe jam shumë e kënaqur që po ju flas sot për profesionin e fotografit.

Fotografët janë njerëz të talentuar, të orientuar dhe shumë të motivuar. Ne jemi artistë që e vëzhgojmë papushim botën që na rrethon dhe tërhiqemi nga e veçanta e saj. Ka raste që fitojmë para, por ka edhe raste që jo. Por ne nuk mërzhitemi kurrë dhe asnjëherë nuk do të donim të kishim një punë tjetër. Synimi im sot është t'ju informoj rreth karrierës sime dhe t'ju nxis të merrni pjesë në një punë vere në studion tonë. Do t'ju shpjegoj se pse pjesëmarrja në një punë të tillë do t'ju ndihmonte shumë në karrierën tuaj të ardhshme, pavarësisht se çfarë profesioni do të zgjidhni.

Gjatë kësaj pune vere në studion tonë, ju do të mësoni rreth pajisjeve cilësore fotografike, programeve për montimin e fotografive, dosjeve elektronike, si është të punosh në një studio të madhe dhe veprimet në biznes. Një fotograf i madh duhet të jetë i aftë në të gjitha këto fusha dhe ne do t'ua mësojmë këto aftësi.

Si fillim, ju do të mësoni të përdorni pajisjet fotografike, për të rritur aftësitë tuaja për të bërë fotografi. Ju do të mësoni të përdorni kamerat digjitale, lentet speciale, filtrat, pajisjet me tri këmbë, blicin, pajisjet speciale për ndriçim dhe printerët fotografikë të cilësisë së lartë. Më kujtohet hera e parë kur vendosa kamerën në një këmbalec. Nuk ia dola ta fiksoj si duhet dhe ajo ra m'u përpara familjes që po fotografoja. Ne do të sigurohemi që të mos ju ndodhin incidente të tilla!

Së dyti, ju do të mësoni të përdorni programe kompjuterike për prerjet anësore të fotografive. Studioja jonë ka programet më të fundit kompjuterike që qarkullojnë në treg. Ju do të ndihmoni profesionistët tanë të montojnë, shkurtojnë, zmadhojnë dhe përforcojnë imazhet më korrektor ngjyrash. Gjithashtu, programi do të krijojë dosje elektronike për secilin nga klientët tanë. Ju do ta përdorni programin së bashku me aftësitë tuaja krijuese për të hedhur fotot e klientëve në faqen e internetit të studios sonë. Studioja jonë do t'ju krijojë mundësi për të pasur kontakt me klientë të mundshëm.

Tani do t'ju jap një informacion më të detajuar në lidhje me studion tonë. Aktualisht ne i ofrojmë klientëve tanë pesë tipa të ndryshëm fotografish. Ne bëjmë fotografi portret, reklamash, shkencore, lajmesh dhe artistike. Ne jemi një nga të paktat studio në këtë vend që mund të bëjmë foto për të gjitha këto fusha. Kjo është arsyeja se pse ofrojmë punë gjatë sezonit të verës. Studioja jonë ka një zyrë biznesi, me disa të punësuar, të gatshëm për t'ju mësuar anën e biznesit të fotografisë. Ne do t'ju mësojmë për reklamën, planifikimin e takimeve, blerjen e pajisjeve, vendosjen e çmimit dhe prerjen e faturave si dhe të gjitha proceset që lidhen me inkuadrimin dhe vendosjen e fotografive në kornizë. Këto aftësi do t'ju vlenin për çdo mjedis profesional që ju do të zgjidhni.

Përfundimisht, ne ju ofrojmë diçka që nuk mund ta gjeni në studiot e tjera. A ju shqetëson mendimi se do të punoni gjatë verës? A mendoni se mund të humbisni një verë gazmore me miqtë tuaj? Mirë, por mendojeni sërish. Studioja jonë ofron mundësi që oraret t'i zgjidhni vetë, kështu që ju mund të programoni kohën tuaj. Ju mund të regjistrohni t'i ndiqni fotografët kur të mundeni dhe në të njëjtën kohë t'i përmbushni orët që kërkohen për trajnim. Gjithashtu, ne do t'ju lejojmë të zgjidhni se cilat ngjarje dëshironi të fotografoni. Ju mund të bëni fotografi në panairë dhe festivalin e zonës, koncertet muzikore, ndërtesat historike, ngjarjet sportive, martesat, mbrëmje dhe shumë ngjarje të tjera.

Dëshiroj t'ju nxis për ta marrë në konsideratë studion tonë të fotografisë, si një mundësi për të bërë një punë në verë. Jam e sigurt se mund të shikoni pse ne e duam kaq shumë punën dhe shpresoj se ju kemi nxitur sado pak për t'u bërë fotografë. Kështu që merrni një vendim dhe bëjuni pjesë e një përvoje të tillë, e cila mund t'ju ndryshojë tërësisht jetën dhe të rrisë shanset për të ardhmen tuaj.

1. Sipas autores, fotografët janë artistë. Çfarë kanë të veçantë ata? **1 pikë**
- A) Mënyrën se si e shikojnë botën.  
 B) Sjelljen e çuditshme kundrejt njerëzve.  
 C) Dëshirën për të bërë punë të ndryshme.  
 D) Padurimin për ta bërë një punë sa më shpejt.
2. Cila nga alternativat e mëposhtme na bind më mirë për të marrë pjesë në këtë program? **1 pikë**
- A) Studioja fotografike ofron një numër të madh punësh sezonale.  
 B) Studioja fotografike mëson praktikantët se si të përforcojnë imazhet.  
 C) Puna sezonale në këtë studio fotografike rrit shanset për të ardhmen e karrierës.  
 D) Praktikantët e studios fotografike përdorin programe kompjuterike për prerjet anësore të fotografive.
3. Tonet e komunikimit përgjatë këtij ligjërimi janë të natyrës së: **1 pikë**
- A) lutjes  
 B) entuziazmit  
 C) sugjerimit  
 D) urdhrit
4. Cila nga fjalitë e mëposhtme shpreh më mirë opinionin e autores për fotografët? **1 pikë**
- A) Fotografët janë njerëz të talentuar, të orientuar dhe shumë të motivuar.  
 B) Ne bëjmë fotografi portret, reklamash, shkencore, lajmesh dhe artistike.  
 C) Si fillim, ju do të mësoni të përdorni pajisjet fotografike për të rritur aftësitë tuaja për të bërë fotografi.  
 D) Ju do të ndihmoni profesionistët tanë të montojnë, shkurtojnë, zmadhojnë dhe përforcojnë imazhet më korrektor ngjyrash.
5. Në cilën prej alternativave të mëposhtme ligjërimi është në vetën e parë njëjës? **1 pikë**
- A) Ne ju ofrojmë diçka që nuk mund ta gjeni në studio të tjera.  
 B) Më kujtohet hera e parë kur vendosa kamerën në një këmbalec.  
 C) A mendoni se mund të humbisni një verë gazmore me miqtë tuaj?  
 D) Fotografët janë njerëz të talentuar, të orientuar dhe shumë të motivuar.
6. Në fjalinë: ... *mund t'jua ndryshojë tërësisht jetën dhe rrisë shanset për të ardhmen tuaj*, fjala *shanset* ka kuptimin: **1 pikë**
- A) aftësitë  
 B) shpresat  
 C) njohuritë  
 D) mundësitë
7. Kujt u drejtohet ky tekst? **1 pikë**
- A) Mësuesve  
 B) Prindërve  
 C) Nxënësve  
 D) Artistëve

8. Cili është referenti i këtij teksti? Identifikoni në paragrafin e pestë dy nga informacionet mbështetëse të tij. **3 pikë**

Referenti: \_\_\_\_\_

Informacioni 1: \_\_\_\_\_

Informacioni 2: \_\_\_\_\_

9.  
a) Cili është mesazhi që përcjell ky test? **1 pikë**

\_\_\_\_\_

- b) Cila është e veçanta që ofron kjo studio dhe që praktikantët nuk mund ta gjejnë në studio të tjera? **1 pikë**

\_\_\_\_\_

- c) Pse autorja e nënvizon faktin se ka punuar për dhjetë vjet në këtë profesion, në një studio tjetër? **1 pikë**

\_\_\_\_\_

10. Cili është qëllimi i autores së këtij teksti? Identifikoni paragrafin ku shfaqet dukshëm ky qëllim. **2 pikë**

Qëllimi: \_\_\_\_\_

Paragrafi: \_\_\_\_\_

11. Zbuloni dy tipare të fotografëve që përmenden në këtë tekst. **2 pikë**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

12. Autorja është përpjekur ta shkruajë këtë pjesë në **mënyrë** të tillë që të tërheqë kandidatët e mundshëm. A mendoni se do t'ia arrijë qëllimit? Mbështetuni në tekst për të dhënë përgjigjen tuaj. **2 pikë**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

13. Në paragrafin e gjashtë gjeni dy shembuj, nga të cilët, njëri i jep atij karakter objektiv dhe tjetri karakter subjektiv. **2 pikë**

Shembull objektiv:

\_\_\_\_\_

Shembull subjektiv:

\_\_\_\_\_

## BAJRON

ÇAJLD HAROLD (*Kënga e lamtumirës*)

1

O lamtumirë! Atdheu im  
po zhduket dalëngadalë,  
gjëmon stuhia me tërbim,  
çaçri gërhet mbi valë,  
pas diellit që po flakëron,  
po nisemi të lirë;  
dhe ty, si atij që perëndon,  
Atdhe, natën e mirë!

2

Kur nesër rishtaz ai diell  
do lindë, me shkëlqim,  
do përhëndesim det e qiell  
po jo atdhenë tim.  
Në vatrën time nuk ka zjarr,  
nëpër avllit' e forta  
të kullës sime rritet bar,  
im qen po leh te porta.

8

Kush u beson psherëtimave  
të femrës që mbush sytë?  
Ia than lotët qepallave  
ndonjë dashnor i dytë.  
S'qaj për gëzimet që humbas,  
rrezikun që më vjen;  
po vetëm qaj se nuk lë pas  
asnjë që lot'n e vlen.  
Në botë mbeta fill i mjerë,  
në detin pa kufi;  
përse të qaj pra për të tjerë  
për mua s'qau njeri.  
Do t'angullijë ndoshta sot  
im qen gjersa të gjejë  
ushqim nga një tjetër zot;  
n'u kthefsha do më shqejë.  
Pra, merrmë, o lundër, dhe vrapo  
në detin plot buçim;  
dhe shpjemë në çdo vend që do,  
veç jo në vendin tim!  
Të falem det i kaltr' i zi!  
dhe kur të shkel i lirë  
në dhe, të falem, shkretëti!  
Atdhe, natën e mirë!

14. Bazuar në këtë fragment, mund të themi se përvojat që ka pasur heroi lirik në të shkuarën:

1 pikë

- A) e kanë nxitur të jetë i dhunshëm.
- B) e kanë bërë atë të pamposhtur.
- C) i kanë shkaktuar shumë zhgënjime.
- D) e kanë bërë ambicioz për të qenë i pari në jetë.

15. Në cilën prej alternativave të mëposhtme sintaksa vjen me rend të ndryshuar?

1 pikë

- A) Çaçri gërhet mbi valë
- B) im qen gjersa të gjejë
- C) S'qaj për gëzimet që humbas
- D) Atdheu im/ po zhduket dalëngadalë

16. Heroi lirik në këtë fragment shfaqet:

1 pikë

- A) i zhgënjyer nga njerëzit e vendit të tij.
- B) i mërzhitur nga shtegtimet e shumta.
- C) i shqetësuar për rreziqet që e presin.
- D) i lumtur që po largohet në vende të panjohura.

17. Cila është figura e stilistikës mbi të cilën janë ndërtuar vargjet e mëposhtme?

1 pikë

*Pra, merrmë, o lundër, dhe vrapo  
në detin plot buçim;  
dhe shpërmë në çdo vend që do,  
veç jo në vendin tim!*

- A) epiteti
- B) krahasimi
- C) përsëritja
- D) personifikimi

18. Në cilin prej vargjeve metafora është shprehur me folje?

1 pikë

- A) në detin plot buçim
- B) të kullës sime rritet bar
- C) në vatrën time nuk ka zjarr
- D) s'qaj për gëzimet që humbas

19. Toni ka karakter lutës në vargun:

1 pikë

- A) Në vatrën time nuk ka zjarr,
- B) Pra, merrmë, o lundër, dhe vrapo
- C) S'qaj për gëzimet që humbas
- D) Në botë mbeta fill i mjerë

20. Identifikoni dy motivet e largimit të heroit nga vendlindja, të cilat janë edhe shkak i përjetimeve që ai po kalon.

2 pikë

Motivi 1:

---

Motivi 2:

---

21. Përshkruani gjendjen shpirtërore të heroit duke e ilustruar me një shembull nga poezia.

2 pikë

---



---



---

22.

a) Në vargun *Në vatrën time nuk ka zjarr*, tregoni të dy kuptimet që mbart fjala *zjarr*.

2 pikë

---



---

b) Çfarë ju bën më shumë përshtypje në këtë fragment? Pse?

2 pikë

---



---

23. Lexoni me kujdes vargjet e mëposhtme. I analizoni ato.

2 pikë

*S'qaj për gëzimet që humbas,  
 rrezikun që më vjen;  
 po vetëm qaj se nuk lë pas  
 asnjë që lot'n e vlen.*

---



---



---

24.

a) Në strofën tetë zbuloni vargjet ku heroi lirik merr një vendim. Cili është vendimi? Analizoni gjendjen shpirtërore të heroit në këtë moment.

3 pikë

---



---

b) Si shfaqet poeti në këtë fragment, si romantik apo realist? Pse?

2 pikë

---



---

